

# STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së, 31 tetor 2014, Nr.1, Viti III

AAB-ja po shndërrohet në një qendër të fuqishme rajonale të studimeve



faqe 4

Prof. dr. Ermir Rogova: AAB-ja ka sjellë robotët e gjeneratës së fundit të NAO-s në Kosovë



faqe 8

Ann Snow: E pashë klasën përplot dhe të motivuar për ta mësuar gjuhën angleze

faqe 10

AAB nderoi studenten Majlinda Kelmendi me Çmimin Ndërkombëtar për Arritje në Sport

faqe 20

## Nisi viti i ri akademik 2014/15 në AAB



Në Institucionin Arsimor AAB, me një ceremoni solemne për studentët e nivelit bachelor, ka nisur viti i ri akademik 2014/2015.

### Filloi viti akademik për studentët e komunitetit boshnjak në Fakultetin Juridik të AAB-së

Në Institucionin Arsimor AAB filluan studimet në gjuhën boshnjake/malazeze në Fakultetin Juridik për

gjeneratën e parë të studentëve të komunitetit boshnjak e malazez të Kosovës.



PRISHTINË  
Institucioni i Arsimit  
UNIVERSITAR AAB

038 555 444 [www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)



# Nisi viti i ri akademik 2014/15 në AAB



Në Institucionin Arsimor AAB, me një ceremoni solemne për studentët e nivelit bachelor, ka nisur viti i ri akademik 2014/2015. Në ceremoninë e pritjes morën pjesë rektori i AAB, prof. dr. Lulëzim Tafa, prorektorët dhe dekanët e njësive akademike, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre.

Rektori Tafa, duke iu dëshiruar mirëseardhje studentëve të rinj në botën universitare tha: "Ky është viti i katërmëdhjetë që AAB organizon një ceremoni të tillë për fillimin e vitit të ri akademik dhe janë përcaktuar një numër shumë i madh i studentëve të rinj krahasuar me vitin e kaluar. Me ju do të punojnë një numër i madh profesorësh, ekspertë të fushave të përzgjedhura, ndërkohë që studentët do të kenë në dispozicion literaturën më të re shkencore, salla, kompjuterë, laboratorët etj., në të tri qendrat: në universitar në Prishtinë, Gjakovë dhe Ferizaj", ka thënë rektori i

AAB-së, z. Tafa.

Një fjalë rasti në këtë ceremoni, ndërlidhur me punën hulumtuese dhe studimore dhe rezultatet e arritura në AAB, e ka mbajtur edhe prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, prof. Xhavit Rexhaj, dekanët dhe prodekanët e të gjitha fakulteteve përkatëse në AAB.

Në ceremoninë e pritjes së studentëve të rinj me nga një fjalë janë paraqitur edhe disa studentë të daluar dhe të diplomuar të AAB-së, suksesi i të cilëve ka nisur në AAB dhe po lulëzon ditë e më shumë. Sipas tyre, të diplomuarit e AAB-së janë të punësuar në kompanitë më të suksesshme në vend dhe më gjerë.

Në pritjen solemne të organizuar me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2014/2015, AAB-ja shtroi edhe nga një kotej rasti për të gjitha fakultetet, ndërsa studentët e rinj vizituan edhe hapësirat dhe infrastrukturën ku do të zhvillohen procesi mësimorë dhe puna praktike.

## Impresum

**STUDENTI**

Gazetë e studentëve të AAB-së

Botues  
BPrAL AAB

Kryeredaktore  
Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e AAB-së

Foto  
Rrahman Drenica dhe Ylli Selmani

Thyerja grafike  
Besfort Mehmeti

e-mail: info@aab-edu.net



# Robotët NAO: Studentë të rinj, mirë se vini në AAB!

Në ceremoninë e pritjes së studentëve të rinj për vitin e ri akademik 2014/2015 në AAB, me nga një fjalë përshëndetëse janë paraqitur edhe robotët NAO. "Studentë të rinj, mirë se vini në Institucionin Arsimor AAB!", ka qenë përshëndetja mirëseardhëse e robotëve NAO. Studentët e rinj, të befasuar me teknologjinë e fundit që ka ky universitet, u bindën se AAB-ja është institucioni i vetëm, i cili ka sjellë robotët e gjeneratës së fundit të NAO-së në Kosovë. AAB-ja me fushën e Shkencave Kompjuterike - Specializimi

për Mekatronikë, është qysh moti e familjarizuar. Në kuadër të këtij fakulteti janë laboratorët më modernë që ekzistojnë jo vetëm në vend, por edhe në regjion. Aty janë edhe robotët NAO. Universitetet më të mëdha në botë e kanë këtë teknologji. Në mesin e këtyre universiteteve ka hyrë edhe AAB-ja, sepse tash e tutje studentët dhe stafi i AAB-së kanë mundësi dhe qasje në teknologjinë më të re shkencore, hulumtuuese dhe profesionale.



# Filloi viti akademik për studentët e komunitetit boshnjak në Fakultetin Juridik të AAB-së



Në Institucionin Arsimor AAB sot filluan studimet në gjuhën boshnjake/malazeze në Fakultetin Juridik për gjeneratën e parë të studentëve të komunitetit boshnjak e malazez të Kosovës.

Programi i Fakultetit Juridik, në të cilin do të studiojnë studentët boshnjakë, është i ngjashëm me programin e akredituar në gjuhën shqipe, ndërsa studimet do të zhvillohen në gjuhën boshnjake. Ky fillim i suksesshëm i këtij programi studimor në gju-

hën boshnjake e malazeze është edhe një pikë e përbushur në planin strategjik të AAB-së për integrimin e të gjitha komuniteteve të Kosovës në kupolën akademike të tij.

Interesimi i studentëve të gjeneratës së parë në këto studime është i konsiderueshëm, ndërsa AAB-ja ka angazhuar një numër të madh të mësimeve me thirrje akademike nga vendi dhe jashtë për realizimin e programit.



**Me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2014/2015, agjencia e lajmeve "Kosovo News Network" (KNN) realizoi një bisedë me rektorin e Institucionit Arsimor AAB, prof. dr. Lulëzim Tafa**

## AAB-ja po shndërrohet në një qendër të fuqishme rajonale të studimeve

*"Këtë vit akademik AAB-ja ka filluar me disa programe dhe forma të reja të studimeve. Kështu, me qëllim të ndërkombëtarizimit të studimeve, tash po fillojmë zbatimin e programit tonë të ekonomisë në gjuhën angleze. Një risi tjetër është se po fillojmë zbatimin e Programit të Juridikut në gjuhën boshnjake/malazeze dhe të Programit të Gazetarisë/Produksionit medial, në gjuhë boshnjake/serbe/malazeze. Gjithashtu, në këtë vit po fillojmë implementimin e një programi të ri master shumë cilësor për Menaxhimin Sektorial. Pra, do të organizojmë studime të veçanta për master në menaxhimin e arsimit, master në menaxhimin e shëndetësisë, master në menaxhimin e kulturës dhe master në menaxhimin e sporteve", tha rektori Tafa*

*KNN: Cilat janë risitë që sjell Universiteti AAB në vitin e ri akademik 2014/2015?*

**Prof. Tafa:** Edhe këtë vit akademik Universiteti AAB, si institucioni më i madh nga sektori jopublik, ka filluar me mësim nga data 1 tetor, gjë që nuk ka arritur ta bëjë asnjë institucion i arsimit të lartë. Risia kryesore për këtë vit, përveç shtimit të kapaciteteve pedagogjike dhe infrastrukturore, këtë vit akademik AAB ka filluar me disa programe dhe forma të reja të studimeve. Kështu, me qëllim të ndërkombëtarizimit të studimeve, tash po fillojmë zbatimin e programit tonë të ekonomisë në gjuhën angleze. Një risi tjetër është se po fillojmë zbatimin e Programit të Juridikut në gjuhën boshnjake/malazeze dhe të Programit të Gazetarisë/Produksionit medial, në gjuhë boshnjake/serbe/malazeze. Gjithashtu, në këtë vit po fillojmë implementimin e një programi të ri master, shumë cilësor, për Menaxhimin Sektorial. Pra, do të organizojmë studime të veçanta për master në menaxhimin e arsimit, master në menaxhimin e shëndetësisë, master në menaxhimin e kulturës dhe master në menaxhimin e sporteve. Jemi përcaktuar për këta sektorë, sepse mendojmë se janë pikërisht institucionet e këtyre sektorëve që vuajnë më së shumti nga mungesa e kadrove profesionale. Një risi tjetër e rëndësishme këtë vit është përqendrimi më i madh në teknologjinë informative, qoftë në aspektin e sigurimit të pajisjeve cilësore për studime, në digjitalizimin e shërbimeve administrative apo në përdorimin e teknologjive



të reja për t'i përmirësuar qasjet dhe metodologjitë e punës, që ta bëjmë të nxënërit më interaktiv dhe më efektiv. AAB-ja ngadalë po shndërrohet në një qendër të fuqishme rajonale të studimeve. Nuk do të lë pa përmendur, gjithashtu, që këtë vit akademik e kemi filluar edhe me një ngjarje të rëndësishme, që neve në AAB na bënë jashtëzakonisht krenarë - kemi ndarë Çmimin Ndërkombëtar për Arritje të Larta në Sport, studentes sonë të artë, kampiones botërore, Majlinda Kel-mendi.

*KNN: Sa ka qenë interesimi i të rinjve këtë vit të studiojnë në Universitetin AAB?*

**Prof. Tafa:** Edhe sivjet, si çdo vit tjetër, AAB-ja është in-

stitucioni për të cilën të rinjtë nga e gjithë Kosova dhe më gjerë kanë shfaqur interesimin për të studiuar. Programet tona atraktive dhe kompatible me kërkesat e tregut, stafi profesional dhe kompetentë mësues, infrastruktura e ndërtuar enkas për universitet, me salla moderne të mësimin, me laboratorë dhe teknologji më të re, por edhe me ambiente të përshtatshme relaksuese, me palestër sportive, salla pinpongu, tenisi, futbollit, basketbollit, salla fitnessi etj., që për studentët tanë janë në dispozicion të vazhdueshëm. Mandej mos të harrojmë se AAB-ja ka edhe Klubin e Debatit, Qendrën Mediale, Revistën Ndërkombëtare Shkencore "Thesis", gazetën e stu-

dentëve, Shtëpinë Mediale ART (Radio, Televizion, Portali Informativ). Pra, mund të themi se ata që e zgjedhën AAB-në kanë pasur të drejtë. Mos ta harrojmë se motoja jonë është "Studenti në qendër". Rrjedhimisht, sivjet kemi interesim kulmues nga kandidatët e rinj. Është mirë që vitin që shkoi i kemi zgjeruar hapësirat për rreth 4 000 metra katrorë, kështu që besoj se do të mjaftojnë për t'i pranuar të gjithë të interesuarit që i plotësojnë kushtet e kriteret për regjistrim. Po ashtu, këtë vit kemi punuar shumë në rekrutimin e numrit të mjaftueshëm të personelit akademik e administrativ.

*KNN: Cilat janë ato drejtime*

*që studentët e ri parapëlqejnë në Universitetin AAB?*

**Prof. Tafa:** Të gjitha programet tona janë të kërkuara. Ne nuk kemi fakultete të vogla. Të gjitha programet tona kanë numër të madh të studentëve dhe edhe këtë vit mund të themi se kemi një shpërndarje propëcionale në të gjitha programet studimore.

**Pos kësaj, është konfirmuar një opinion se të diplomuarit e AAB-së konkurrojnë me cilësi e jo vetëm me diploma**

*KNN: Studentëve të rinj (brucoshë) u intereson edhe një fakt shumë domethënës, se cila është perspektiva e tyre pas diplomimit në AAB?*

**Prof. Tafa:** Është edhe ky një



element shtesë që e dallon AAB-në, krahasuar me institucionet e tjera. Në këtë plan preokupimi ynë nuk janë vetëm studentët aktualë. Zyra jonë për karrierë mban evidenca të sakta për të gjithë të diplomuarit tanë. Shkalla e pranueshmërisë së diplomave tona në tregun e punës është shumë e lartë, shumica e të diplomuarve tanë (mbi 90 për qind) gjejnë punë menjëherë pas përfundimit të studimeve. Studentët tanë tani ushtrojnë profesionet e tyre me shumë kompetencë kudo që punojnë në institucione publike e private, punëdhënësit i kanë të hapura dyert për të diplomuarit tanë. Kjo mendoj se është më e rëndësishmja për ne. Të dhënat që ka zyra jonë për të diplomuarit tanë janë vërtet impresionuese. Pos kësaj, është konfirmuar një opinion se të diplomuarit e AAB-së konkurro-

jnë me cilësi e jo vetëm me diploma. Këtë më së miri e dëshmojmë me shembullin se në një drejtim master kanë konkurruar i tërë grupi prej 110 studentësh - prej të cilëve tashmë më shumë se gjysma janë të punësuar.

**KNN: Dihet së në Republikën e Kosovës AAB-ja është universiteti me numër, programe, infrastrukturë dhe më cilësori. Si e shihni konkurrencën në raport me universitetet në regjion dhe më tej?**

**Prof. Tafa:** Sa i përket konkurrencës, mendoj se AAB-ja tanimë e ka bërë diferencën. Kemi edhe shumë punë për të bërë. Është fakt. Siç është fakt se ne jemi më të mirët. Nuk e themi vetëm ne këtë. Këtë e thonë të gjithë. Ne kemi kaluar disa runde të akreditimit me ekspertët më të njohur ndërkombëtarë të fushave të caktuara. Mund të

lexohen raportet e tyre. Ato janë publike dhe gjenden në faqen zyrtare të Agjencisë së Akreditimit. Por, treguesi kryesor padyshim se janë studentët tanë, që kanë diplomuar te ne, dhe suksesi i tyre në profesionet që ushtrojnë. Kjo na jep më shumë siguri në punën që po bëhet këtu.

**KNN: Studentëve u intereson edhe fakti tjetër, se si e shihni të ardhmen e këtij universiteti?**

**Prof. Tafa:** Ne e kemi planin tonë strategjik dhe vizionin e misionin tonë të përcaktuar qartë. Ne në vitet në vijim do të përqendrohemi më shumë në shkencë dhe në punën praktike të studentëve. Pos kësaj, do ta zgjerojmë ofertën e studimeve me programe në gjuhën angleze dhe në gjuhët e komuniteteve të Kosovës.

**KNN: Cili është mesazhi juaj, drejtuar studentëve brucoshë?**

**Prof. Tafa:** Po, do t'u drejtohem atyre që zgjedhën AAB-në për të studiuar, t'i falënderoj për këtë zgjedhje dhe t'u them se ne, i gjithë stafi menaxhues, stafi pedagogjik, stafi administrativ dhe ai teknik, jemi në shërbim të tyre. Në hierarkinë e AAB-së

i pari është student, pastaj profesorët dhe krejt në fund jemi ne, stafi menaxhues - të gjithë në shërbim të studentëve. Pas tre vjetëve të studimeve ajo që dëshirojmë ne është, që ata të jenë krenarë me universitetin e tyre, kurse ne krenarë me suksesin e studentëve tanë.

Intervistoi: N. Demiri



## Stafi i Zyrës për Karrierë të AAB-së, vizitë studimore në Universitetin e Edinburgut në Skoci

AAB-ja vazhdimisht është përfituese e rregullt e projekteve të Bashkimit Evropian dhe të tjera. Gjatë javës së kaluar prorektori i Institucionit Arsimor AAB, Xhavit Rexha, si dhe ligjëruesi i Fakulteti të Juridikut, Mensut Ademi, morën pjesë në punëtorinë "Asistenca

teknike për Horizon 2020" - program i Komisionit Evropian.

Kjo punëtori kishte për qëllim të ofrojë informacione për rëndësinë që ka ky program për zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe të ofrojë udhëzime për aplikimin me projekte nga ana e subjek-

teve të interesuara.

Përveç stafit të AAB-së, në këtë punëtori kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të dikastereve nga sektori i arsimit, shkencës dhe teknologjisë nga vendi, si dhe palë të tjera të interesit.

## Stafi i AAB-së mori pjesë në punëtorinë "Asistenca teknike për Horizon 2020"



AAB-ja vazhdimisht është përfituese e rregullt e projekteve të Bashkimit Evropian dhe të tjera. Gjatë javës së kaluar prorektori i Institucionit Arsimor AAB, Xhavit Rexha, si dhe ligjëruesi i Fakulteti të Juridikut, Mensut Ademi, morën pjesë në punëtorinë "Asistenca teknike për Horizon 2020" - program i Komisionit Evropian.

Kjo punëtori kishte për qëllim të ofrojë informacione

për rëndësinë që ka ky program për zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe të ofrojë udhëzime për aplikimin me projekte nga ana e subjekteve të interesuara.

Përveç stafit të AAB-së, në këtë punëtori kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të dikastereve nga sektori i arsimit, shkencës dhe teknologjisë nga vendi, si dhe palë të tjera të interesit.



Anketë me studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB

# Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB, më i kompletuari në vend dhe rajon, vlerësojnë studentët

*Shumica e të diplomuarve në Fakultetin e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në Institucionin Arsimor AAB janë të punësuar nëpër medime dhe institucionet më të mëdha shtetërore dhe private, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Sukseset dhe të arriturat e këtyre studentëve janë edhe disa nga arsyet pse të anketuarit tanë kanë vendosur të studiojnë në këtë fakultet.*

Të anketuarit janë përgjigjur në pyetjen: Pse vendosët të studioni në Fakultetin e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB?



**Agonjeta Kelmendi:**

Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB është fakulteti më i mirë jopublik në vend dhe në rajon. Të diplomuarit në këtë fakultet sot gëzojnë vende të mira pune si gazetarë, kryeredaktorë, menaxherë mediesh, zëdhënës të institucioneve më të rëndësishme shtetërore, ekspertë të profil-it publik etj., prandaj vendosa të studioj në këtë fakultet.



**Blerina Osmani:**

Nga afër i vizitova të gjitha universitetet publike dhe jopublike dhe vërejtja se Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB është i vetmi fakultet që për studentët e vet ka krijuar edhe infrastrukturën e nevojshme për punë praktike gjatë periudhës së studimeve, si ART Televizion, Radio AAB dhe portalin KNN.



**Diellza Musaj:**

Për dallim nga tjerët, në Fakultetin e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB kushtet për studime janë tejet të mira dhe besoj se këto kushte të studimit asnjë universitet në vendin tonë nuk i ofron. Unë për tre vjet të studimeve në vazhdim dua të fitoj gjithçka që është e mundur në profesionin tim nga ky fakultet që t'i ndihmoj shoqërisë sime në të ardhmen. Synoj që në të ardhmen të bëhem një gazetare, më vonë edhe menaxhere e ndonjë mediumi.



**Rina Ymeri:**

E kam vërejtur se vullneti i stafit akademik në Fakultetin e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë është për të na bërë neve sa më profesional në këtë lëmë që po nisim të studiojmë. Synoj që pas përfundimit të studimeve në AAB do të dal një gazetare e kompletuar në tregun e punës sikurse të diplomuarit e tjerë në AAB, shumica e të cilëve punojnë dhe gëzojnë pozitën më prestigjioze për profesionin që e ushtrojnë.

**Rina Elshani:**

Të diplomuarit e Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB, të cilët kanë dashur t'i vazhdojnë studimet jashtë vendit, janë pranuar pa problem nëpër universitete më prestigjioze të Evropës dhe më tej. Pas përfundimit të studimeve bachelor, edhe unë do ta ndjek rrugën e tyre nëpërmjet këtij institucioni dhe të kthehem të kontribuoj për vendin tim.

**Fatlind Duraku:**

Ndërlidhja e teorisë me punën praktike është një ndër gjërat kryesore që i duhet një studenti, e AAB-ja është i vetmi që e ofron këtë. Në AAB kushtet për studime janë tejet të mira dhe besoj se këto kushte të studimit asnjë universitet në vendin tonë nuk i ofron.


**Labint Nimani:**

Besoj se gjatë studimeve të bëra në këtë fakultet do ta mësoj mirë mjeshtrinë e gazetarisë dhe në të ardhmen ta zotoj profesionin që kam zgjedhur.

**Mendimi i personelit të AAB-së**

Përfaqësues të Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB janë shprehur të kënaqur me studentët e diplomuar në këtë fakultet. "Jemi të ngazëllyer me punën dhe profesionalizmin e tyre. AAB i ka dhënë vendit ekspertë dhe menaxherë të suksesshëm të fushës së medias", kanë thënë përfaqësues të AAB-së.

Sipas statistikave të sakta të nxjerra në AAB, numri i studentëve të diplomuar në këtë fakultet sillet mbi 90 %.





**Me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2014/2015, agjencia e lajmeve "Kosovo News Network" (KNN) realizoi një bisedë me dekanin e Fakultetit të Fakultetit të Shkencës Kompjuterike në AAB, prof. dr. Ermir Rogova**

## Prof. dr. Ermir Rogova: AAB-ja ka sjellë robotët e gjeneratës së fundit të NAO-s në Kosovë

*"Gjatë punës praktike me NAO studentët do të ballafaqohen me aspekte të ndryshme të këtyre fushave, me ç'rast do të fitojnë njohuri të nxjerra nga teoria dhe nga pjesa praktike. E them me bindje të plotë që studentët tanë të Shkencave Kompjuterike, të cilët diplomojnë, nuk do ta kenë problem punësimin, qoftë brenda apo edhe jashtë Kosovës", ka thënë Rogova*



**KNN:** A është risi për studentët ardhja e robotëve në Kosovë?

**Prof. Rogova:** Ardhja e robotëve NAO në Kosovë është shumë e re. Për momentin vetëm dy institucione i kanë këta robotë dhe AAB-ja është një prej tyre. Megjithatë, më duhet të theksoj se ne kemi versionin e fundit të këtyre robotëve, i cili ka vetëm disa muaj që ka dalë në treg dhe është më i avancuar se versionet e tjera. Robotët NAO, prej të cilëve institucioni ynë ka dy, janë fjala e fundit e robotikës që mund të blihet. Ekzistojnë robotë më të avancuar siç është rasti me robotin Asimo i prodhuar nga Honda. Ai është vetëm një prototip i cili nuk shitet.

**KNN:** Sa është interesimi i të rinjve që të dinë për robotët NAO?

**Prof. Rogova:** Prej momentit kur i kemi paraqitur, robotët NAO kanë zgjuar një interesim jashtëzakonisht të madh të të gjithë ata që i kanë parë. Ky interesim ka qenë edhe më i madh te studentët e Fakultetit të Shkencës Kompjuterike. Nuk kalon ditë që nuk na paraqiten studentë me pyetje për NAO-të. Bile kemi pasur kërkesa nga studentët që nuk janë të drejtimit të mekatronikës për të hapur një lëndë zgjedhore

në të cilën do të mësonin të punonin me NAO.

**KNN:** Çfarë mësojnë studentët nga robotët NAO?

**Prof. Rogova:** Parimisht, NAO-t i takojnë laboratorit harduerik në kuadër të FSHK-së. Puna me ta ndërlidh disa aspekte të studimeve të shkencave teknike. Aty mishërohen mekanika, sensorika dhe programimi. Studentët që do të punojnë në programimin e NAO-s do të jenë shumë të aftë në të gjitha këto aspekte. Duhet ta kemi parasysh se kemi të bëjmë me një sistem shumë kompleks. Robotët NAO kanë numër të madh të motorëve dhe nyjave lëvizëse që mundësojnë lëvizje të ndryshme, duke filluar nga ato më të thjeshtat si ngritja e dorës, pastaj ecja, deri te vallëzimi apo luajtja futbolli. Ata kanë numër të madh të sensorëve të prekjes në duar dhe këmbë si dhe katër mikrofon për të detektuar nga cili drejtim po u vjen zëri. Po ashtu, kanë sensorë për t'i detektuar objektet edhe në terr të plotë, dy kamera të cilat përdoren për detektimin e objekteve, si dhe sensorë të tjerë.

**KNN:** Studentëve brucoshë u intereson se ku mund t'i aplikojnë njohuritë e fituara

nga NAO-t?

**Prof. Rogova:** Kjo është një pyetje shumë me vend, të cilën ne e kemi gjithmonë në mendje. Pak më parë përmenda sensorët e ndryshëm të NAO-s. Puna praktike të cilën do të zhvillojnë studentët tonë me NAO përfshin shumë aspekte të cilat kanë përdorim të gjerë. Njohja e punës me sensorë dhe mekanika e lëvizjes së gjymtyrëve është një cilësi shumë e dëshiruar në industrinë e automatizuar. Programimi i të folurit dhe kuptimi i të folurit është një cilësi tjetër shumë e dëshiruar në sistemet inteligjente. Detektimi dhe identifikimi i fytyrave të personave është pjesë e një fushe shumë e fuqishme në shkencë kompjuterike që quhet "image recognition", e cila ka përdorim të gjerë, duke filluar prej kamerave të trafikut, në aeroporte, e deri në diagnostifikim në mjekësi. Pastaj inteligjenca artificiale etj. Gjatë punës praktike me NAO studentët do të ballafaqohen me aspekte të ndryshme të këtyre fushave, me ç'rast do të fitojnë njohuri të nxjerra nga teoria dhe nga pjesa praktike. E them me bindje të plotë që studentët tanë të Shkencave Kompjuterike, të cilët diplomojnë, nuk do ta kenë problem punësimin, qoftë brenda apo edhe jashtë Kosovës.

**Rogova: Misioni ynë është që ky fakultet të jetë lider në rajon**

**KNN:** Cilat janë risitë që sjell AAB-ja në vitin e ri akademik 2014/2015?

**Prof. Rogova:** Në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike këtë vit kemi shumë risi. Misioni ynë është që ky fakultet të jetë lider në rajon. Në këtë drejtim kemi punuar dhe investuar shumë. Kemi

bërë një përzgjedhje të re të stafit akademik më të mirë të mundshëm, duke mos hezitur të marrim ekspertë të fushave nga i gjithë rajoni dhe më gjerë. Kemi pajisur dy laboratorë softuerikë me dy serverë dhe 60 kompjuterë të rinj të gjeneratës së fundit. Këto pajisje do të jenë për përdorim ekskluziv mësuesor të studentëve të Fakultetit të Shkencës Kompjuterike. Laboratori i ri harduerik është në proces të pajisjes me mjete konkretizuese harduerike, të rretave, pllaka elektronike, pllaka Arduino dhe ai është vendbanimi edhe i dy robotëve Nao. Po ashtu, kemi arritur ta regjistrujmë Fakultetin e Shkencës Kompjuterike në programin Dreamspark Premium të Microsoftit, duke u bërë kështu institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë me këtë anëtarësim. Dreamspark

është program i Microsoftit për mbështetjen e edukimit teknik, i cili u mundëson të gjithë studentëve dhe stafit të Fakultetit të Shkencës Kompjuterike qasje pa pagesë për shkarkim me licenca të gati 200 produkteve të ndryshme softuerike të Microsoftit. I gjithë softueri i përdorur në laboratorët e FSHK-së do të jetë i licencuar nga Microsofti. Po ashtu, studentët dhe stafi mund të shkarkojnë pa pagesë dhe me licenca po këta softuerë për përdorim privat për qëllime mësuesor dhe t'i instalojnë ata në pajisjet në shtëpitë e tyre. Me këto risi që i kemi sjellë në FSHK, jemi të bindur që brenda një kohe të shkurtër do ta arrijmë misionin që ia kemi dhënë vetës.

*Intervistoi: N. Demiri*





# AAB-ja, i vetmi në vend që ofron edhe shërbim shëndetësor për studentë pa pagesë

AAB-ja është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë që, krahas shërbimeve të tjera, për studentët e vet ofron edhe shërbime shëndetësore nëpërmjet Ambulancës Mjekësore, e krijuar brenda kampusit të Prishtinës.

Nën udhëheqjen e menaxhmentit të lartë AAB dhe doktoreshës Lejlifere Shabanaj, ambulanca mjekësore në AAB ofron shërbime dhe përkushtim ndaj pacientëve, studentëve dhe stafit universitar dhe atij administrativ, shpejt dhe në mënyrë shumë cilësore. "Gjatë trajtimit në krijojmë marrëdhënie të

sinqerta me pacientin gjatë të gjitha fazave të trajtimit dhe ia ofrojmë shërbimin e duhur. Për çfarëdo problemi të pacientëve ne punojmë shpejt dhe mirë për të gjetur zgjidhje sa më parë", u shpreh doktoresha Shabanaj.

Ajo shtoi se kohët e fundit pacientët, stafi dhe studentët na janë paraqitur për matje të tensionit arterial, dhimbjeve, gastritit, diarresë, lëndimeve, gripeve, ftohjes etj.

Praktika e pasjes së ambulancave universitare zbatohet në të gjitha universitetet më prestigjioze në Evropë

dhe botë. Ambulanca e AAB funksionon që nga viti 2008, ndërsa gjendet në mes të kampusit universitar, në godinën e dytë. Me këtë hap AAB po e rrit cilësinë e përgjithshme të kushteve për studime, ndërsa me numrin vazhdimisht në rritje të studentëve të regjistruar dhe me kushtet e infrastrukturës së përgjithshme, ky universitet po kthehet në model për institucionet e arsimit të lartë në vend dhe regjion. Ambulanca e AAB-së është e hapur për studentë dhe stafin e vet çdo ditë prej orës 8:40 deri në orën 16:40.



## Tre studentë të AAB-së janë certifikuar për trajnerë

Fakulteti Juridik në AAB, Qendra e Studimeve Juridike Kriminalistike të Sigurisë (QSJKS), në bashkëpunim me Asociacionin e Kriminalistëve dhe Kriminologëve të Kosovës (ASKK), për disa ditë me radhë kanë organizuar trajnim, me ç'rast studentët e Fakultetit Juridik të AAB-së, Valon Dobratiqi, Mexhide Fazliu dhe Enis Vërbovci, i kanë certifikuar si trajnerë për trajnimin "Kuptimi i të Drejtave të Njeriut". Trajnimi është mbajtur nga Qendra për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të UP-së si dhe me përkrahjen e Friedrich Ebert Stiftung.

Ligjërues ka qenë Wolfgang Benedek, profesor i Universitetit të Grazit, drejtor i

Qendrës për Hulumtim dhe Trajnim në të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci në Graz si dhe redaktor i Manualit. Trajnim e studentëve e mundësuan profesorët Valon Murati dhe Mensur Ademi.



## Takim mes përfaqësuesve të dy institucioneve për shkollimin e minoriteteve në AAB

Prorektori për bashkëpunim, Xhavit Rexhaj, si dhe Ganimete Ismajli, asistente në AAB, janë takuar me Sergjan Popoviqin, drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ata kanë diskutuar për veprimtarinë e ndërsjellë dhe mundësinë e bashkëpunimit në avancimin e arsimit të pjesëtarëve të komuniteteve në nivelin e arsimit të lartë.

Z. Popovic informoi për punën e zyrës në avancimin e jetës së komuniteteve, me fokus në aktivitetet për shkollimin dhe arsimin e tyre. Biseda u fokusua në programin e ri të studimeve - Dega e Drejtësisë në AAB në gjuhën boshnjake, malazeze, serbe, të cilën po e vijojnë pjesëtarët



e komuniteteve përkatëse. Pjesëmarrësit u morën vesh për hartimin e një informacioni më të hollësishëm për këtë program, përfshirë sukseset e deritanishme dhe sfidat që dalin përballë implementimit të tij sa më cilësor. U diskutua edhe për organizimin e programit për fushën e gazetarisë në të ar-

dhmen dhe përpjekjet e krijimit të kushteve për një gjë të tillë për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Në fund palët u morën vesh të ndihmohet në informimin më të mirë të partnerëve socialë dhe atyre vendorë e ndërkombëtarë që bashkëpunojnë me Zyrën për Çështje të Komuniteteve.



AAB-ja vazhdimisht bashkëpunon me Ambasadën e SHBA-së në Kosovë

# Ann Snow: E pashë klasën përplot dhe të motivuar për ta mësuar gjuhën angleze

Në kuadër të programeve të shumta të studimit dhe programeve për ecjen e saj drejt ndërkombëtarizimit, AAB-ja vazhdimisht bashkëpunon me Ambasadën e SHBA-së në Kosovë. Andaj, në kuadër të këtij bashkëpunimi, profesoresha e njohur nga Universiteti Shtetëror i Kalifornisë, Ann Snow, për tetë ditë ka qëndruar në AAB.

Studentja e AAB-së, Dafina Ismajli, në bashkëpunim me disa punonjës nga stafi i këtij institucioni, shfrytëzuan rastin dhe realizuan një bisedë për përshtypjet dhe punën e saj të bërë gjatë kësaj kohe në këtë institucioni etj.

*“Gjatë ditëve që kalova këtu jam impresionuar me infrastrukurën që pashë. Sallat e mësimit këtu janë më të mira se sallat e mia të mësimit në Kaliforni. Studentët janë me shumë fat që janë pjesë e këtij kampusi me këta profesorë të kualifikuar. Po ashtu, ka mundësi të kesh përvoja të ndryshme me fakultete të ndryshme. Studentët e Komunikimit Masiv mund të hyjnë në studio të ndryshme dhe të praktikojnë atë që e mësojnë, ose studentët e gjuhës angleze që kanë një praktikë profesionale (intership), që do të thotë të shkojnë në klasë dhe të bartin tek të tjerët atë çka ka mësuar edhe vetë në klasë”, tha profesoresha Snow.*

**KNN:** Pse janë të rëndësishme shkathtësitë gjuhësore të gjuhës angleze?

**Prof. Ann Snow:** Kënaqësia e punës sime është udhëtimi nëpër vende të ndryshme të botës, për ta ligjëruar gjuhën angleze. Edhe pse jetoj në SHBA, kam një perspektivë globale, sepse bëj programe të tilla mjaft shpesh për Departamentin e Shtetit Amerikan dhe për t'i përmbushur obligimet e

Mendoj se qasja në gjuhën angleze në këtë fakultet u ofron studentëve opsione më të mira për punësim në një ambient ndërkombëtar, ku anglishtja mund të përdoret në fushën e biznesit, tregtisë ose në ndonjë ndërmarrje të huaj, të themi gjermane. Në themi se anglishtja është 'lingua franca', një lloj gjuhe për komunitete me të gjëra që përdoret në mbarë botën, sidomos në BE, në kontekst

angleze apo i cilëso gjuhë. Me rëndësi është t'i kesh njohuritë e mjaftueshme në fushën tënde të studimit dhe gjithmonë impresionohem. Meqenëse jam mësimdhënëse e gjuhës angleze dhe në të njëjtën kohë anglishtja është gjuhë e imja amtare, nuk e kam ndjerë atë sfidën linguistike, por që natyrisht më është dashur ta mësoj metodologjinë e mësimdhënies.

**Prof. Ann Snow:** Unë quhem Marguerite Ann Snow dhe jam profesoreshë në Universitetin Shtetëror të Kalifornisë. Jam me fat që jam në Kosovë për tetë ditë sipas ftesës së bërë nga Ambasada Amerikane. Fusha ime e profesionalizmit është mësimdhënia e gjuhës angleze, e cila në anglishten amerikane njihet si TESOL (të ligjëruarit e gjuhës angleze për studentët e huaj), kurse në anglishten britanike njihet si TEFL, (të ligjëruarit e gjuhës angleze si gjuhë e huaj). Gjatë këtyre tetë ditëve do të jem e pranishme në orë të mësimit, do të takohem me mësimdhënësit dhe me studentë dhe do t'i vëzhgoj aktivitetet e ndryshme në Kampusin e AAB-së. Të hënën isha në Ferizaj. Aty pashë kampusin. Ishte gjë e mirë ta shoh natyrën, t'i takoj studentët dhe pata mundësinë t'i vëzhgoj studentët e rregullt dhe ata pa shkëputje nga puna, që është karakteristikë e veçantë e AAB-së. Kjo është një përparësi në Kosovë, pasi studentët kanë mundësi të ndjekin studime si ata të moshës së re, 18-20 vjeçar, por edhe persona që punojnë dhe që nuk kanë pasur mundësi t'i përfundojnë studimet e tyre. Kam vëzhguar në orë të mësimit, kam biseduar me disa profesorë dhe staf dhe më vjen mirë që e kam Dafinën këtu,



e cila ishte e pranishme në orë të mësimit. Pashë klasën përplot me të motivuar për ta mësuar gjuhën angleze, ku ne në dialektin tonë i quajmë "Freshmen" studentët e vitit të parë, për dallim prej jush që i quani studentë të vitit të parë dhe të dytë. E çmoj ndihmën e Dafinës sot.

**Pasi vendi është në zhvillim, ka nevojë për gjuhë angleze, e mësimi i saj për studentët pa shkëputje nga puna është një mundësi për ta për punën që e bëjnë si dhe për përfitim**

mia në universitet me duhet të udhëtoj shpesh dhe kështu vërej kërkesën shumë të madhe për gjuhë angleze në mbarë botën. Këtë e kam vënë re veçanërisht në Kosovë. Derisa e ndërtoni shtetin tuaj, anglishtja ecën krah për krah me këtë zhvillim. Të gjithë e dinë se anglishtja është gjuhë ndërkombëtare, por të gjitha shtetet kanë nevojë ta ruajnë gjuhën e vet. Kjo nënkupton që edhe Kosova duhet ta ruajë gjuhën shqipe, prandaj e shoh anglishten si një gjuhë shtesë në repertoarin e secilit student.

të bizneseve dhe të tregtisë kombëtare dhe për shumë mundësi të tjera. Isha në klasën e Dafinës dhe i pyeta 52 studentë çfarë dëshirojnë të bëhen? Shumica nga ta më thanë mësimdhënës, dhe meqenëse unë jam mësimdhënëse, më gëzon kur shumë të rinjtë kërkojnë të njëjtin profesion sepse është profesion që shpërblen pa marrë parasysh fushat, qoftë matematikë, shkencë etj. Mësimdhënia është profesion që ka shumë shpërblime dhe mendoj se është e rëndësishme të jesh mësimdhënëse qoftë i gjuhës

Ju jepni mësim në një gjuhë të dytë, por përderisa për mua është gjuhë e parë, dhe lirisht mund të them se kjo është shumë e lehtë për mua, ju në anën tjetër keni një sfidë të dyfishtë. Mendoj se jeni shumë me fat që keni një fakultet me mësimdhënës aq të përkushtuar, po ashtu keni kolegë që janë shumë të motivuar. Besoj se keni mundësi ta mësoni gjuhën angleze në të ardhmen. Lirisht mund të mendoni për profesionin lidhur me gjuhën angleze, p.sh anglishtja për turizëm. Fola me studentë dhe më



thanë se u duhej anglishtja për një komunikim më të gjerë. Po ashtu, pasi vendi është në zhvillim, ka nevojë për gjuhë angleze, e kjo për studentët pa shikëputje nga puna është një mundësi për ta, për punën që e bëjnë si dhe për përfitim material. Po ashtu, p.sh spanjishtja është gjuhë e dytë për mua. Në një moment gjuha tjetër të ofron një kulturë tjetër, qasje në letërsi. Në fakt, kur isha në Ferizaj fola me disa studentë për dramën e Shekspirit, kështu që ata studentë në atë orë patën rastin ta përjetojnë gjuhën shekspiriane, po ashtu në kuptimin e filmave, të muzikës, përdorimin e internetit. Pra, është një mundësi të mësosh diçka më tepër dhe ta zgjerosh horizontin përtej gjuhës së parë.

**KNN: Cilat janë sfidat kryesore në të mësuarit në gjuhën angleze?**

**Prof. Ann Snow:** Vështirësitë janë të ndryshme. Këtë mëngjes po flisim për përdorimin e ndajfoljes, vështirësitë shtohen kur ngritet niveli i gjuhës angleze dhe sfida është më e madhe. Sot ju mësoni më shumë se një gjuhë, ju mësoni edhe një kulturë tjetër. Kjo është një sfidë. Unë jetoj në Kaliforni dhe të gjithë studentët që vijnë atje i ekspozohen gjuhës angleze shumë më tepër, përderisa ju këtu e keni një ekspozim dukshëm më të limituar. Por, këtë e ka ndryshuar tej mase përdorimi i internetit. Studentët kosovarë me përdorimin e internetit kanë qasje shumë më të madhe në gjuhën angleze si gjuhë e dytë. Gjatë ditëve që kalova këtu jam impresionuar me infrastrukturën që pashë, p.sh sallat e mësimit këtu janë më të mira se sallat e mia të mësimit në Kaliforni. Studentët janë shumë fat që janë pjesë e këtij kampusi me këta profesorë të kualifikuar. Po ashtu, ka mundësi të kesh përvoja të ndryshme me fakultete të ndryshme. Studentët e komunikimit masiv të hyjnë në studio të ndryshme dhe të praktikojnë atë që e mësojnë, ose studentët e gjuhës angleze që kanë një praktikë profesionale (intership), që do të thotë të shkojë në klasë dhe të bartë tek të tjerët atë çka ka mësuar edhe vetë në klasë.

**KNN: Cilat janë sfidat kryesore të profesorëve në mësimit**



*dhënien e gjuhës angleze?*

**Prof. Ann Snow:** Ka shumë sfida në përpilim të planpogramave dhe materialeve. Përshtypja ime e parë është që planpogramet kanë përputhje të mirë. Përshtypja tjetër është se ju keni grupe shumë të mëdha, por gjatë bisedës me studentë, mësova se grupet nëpër universitete të tjera janë edhe më të mëdha. Për mua kjo është e pabesueshme, të japësh mësim në një klasë me 200 studentë dhe të praktikosh të dëgjuarit, patjetër se duhet të jesh i mençur t'i mbash gjithë ata persona të motivuar. P.sh, këtë mëngjes isha në një klasë me më shumë se 50 studentë dhe mendoj se numri ideal në një klasë ku mësohet gjuha e jo ku ligjërohet gjuha, duhet të jetë 20 studentë. Një ndër kompetentet kryesore në një program mësimit është t'i japësh rast studentit të bashkëveprojë, por profesori këtë mëngjes bëri një punë të suksesshme dhe i vendosi në grupe nga tre, duke e maksimalizuar kështu bashkëveprimin mes studentëve. Edhe pse këtu grupet janë më të vogla se në institucionet e tjera, prapë kjo mbetet një sfidë: të gjithë profesorët ballafaqohen me motivimin e studentëve. Besoj se kjo është sfida kryesore, pra si t'i motivojmë studentët. Më pëlqen të mendoj, dhe këtë pikërisht e bëj në trajnimet e mia të mësimit, se profesori ka një rol të madh në këtë. Pra, t'i bësh orët e mësimit interesante, argëtuese, kuptimplotë dhe bashkëvepruese. Kështu studentët do të jenë të motivuar, edhe pse varet nga vetë studentët se si e gjejnë motivimin. Pra, puna e mësimit është një rrugë me dy kahe: t'i motivojë studentët dhe të jenë

të motivuar për punën që e bëjnë. E në AAB studentët kanë rast të shkëlqyeshëm të jenë të motivuar.

**KNN: Cilat janë metodat më të mira të mësimit dhe mësimit sipas mendimit tuaj?**

**Prof. Ann Snow:** Me orët e gjuhës angleze nuk duhet të jemi të kënaqur nëse ato që përqendrohen vetëm në të mësuarit e gramatikës. Duhet patjetër që orët tona t'i bëjmë bashkëvepruese, kuptimplotë, argëtuese. Në fakt, unë e dua gramatikën, se vetë jam gjuhëtare, por studentët nuk duhet patjetër që gramatikën ta mësojnë duke mbajtur në mend rregulla. Kështu që, kur jap mësim në orët e metodikës, flas edhe për rolin e gramatikës por në formë tjetër. P.sh, nëse studentët duan të flasim për parashikimin, atëherë cilat janë shprehjet gramatikore për ta shprehur një parashikim, ose kur duan të bëjnë një ftesë ose një koment, ose të bëjnë një debat. Të gjitha këto funksione patjetër që kërkojnë gramatikën. Kështu që, mendoj se metoda më e mirë se si mund ta mësojnë studentët gjuhën e vërtetë, është që gjuhën

ta përdorim në këto funksione. Mund të përdorim edhe gjuhën e të folurit, por ka shumë studentë që janë të interesuar për gjuhën akademike. Metoda më e mirë për ta mësuar gjuhën akademike për studentë është të mësojnë atë që ne e quajmë 'instruksione të bazuara në përmbajtje'. Në këtë kontekst, studentët mësojnë për tema për të cilat janë të interesuar nëpërmjet anglishtes. P.sh, kisha një grup i cili po zhvillonte një njësi që kishte të bënte me tërmetet, (kjo është temë e rëndësishme në Kaliforni të Jugut). Studentët mësuan terminologjinë rreth tërmete-

**KNN: Cilat janë shkathësitë që i shihni si të domosdoshme për studentët që të kenë sukses në këtë proces?**

**Prof. Ann Snow:** Motivimi është gjithsesi një komponentë e rëndësishme dhe studentët për ta mësuar një gjuhë domosdoshmërisht do të bëjnë edhe gabime. P.sh, unë kur flas spanjisht bëj gabime. Pra, të bësh gabime është proces i të mësuarit. Gabimet i konsiderojmë si pjesë e procesit të të mësuarit, i shohim si dritare

në këtë proces. Mendoj se studentët duhet të kuptojnë se gabimi është një dukuri e natyrshme dhe profesorët duhet t'i inkurajojnë studentët, ngaqë shumica e studentëve që kanë një nivel mesatar të dijes dhe njohurive ka gjasa të mbesin në po atë nivel dhe mos të zhvillohen më, dhe unë e shoh në Fakultetin e Gjuhës Angleze mundësinë e një zhvillimi të tillë, mundësinë e kalimit nga niveli mesatar në nivel të avancuar, e nga ajo që po vërej në Fakultetin e Gjuhës Angleze është lehtë e mundshme.

**KNN: Cilat lëndë i konsideroni më të rëndësishme për studentët e gjuhës angleze?**

**Prof. Ann Snow:** Në këtë pikë duhet ta dimë se të gjithë studentët duhet t'i përvetësojnë 4 shkathësitë: të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit. Shkathësitë e bashkëbisedimit janë të rëndësishme, niveli i lartë i të shkruarit dhe të lexuarit kërkon nga studentët të lexojnë shumë. E di se kjo gjeneratë nuk lexon shumë, e kam një vajzë 17-vjeçare e cila nuk lexon shumë, por të lexuarit është kënaqësi dhe profesorët duhet t'i motivojnë studentët të lexojnë më shumë. Kjo është një vështirësi, por pikërisht këtu hyn në punë profesioni i profesorit, i cila duhet ta lehtësojë punën. Shumica e shtëpive botuese kanë versione të thjeshtuara apo të adaptuara të veprave të mëdha. Ka shumë mënyra që t'ua paraqesin studentëve nivelin e lartë të të shkruarit. Ishte vërtet kënaqësi që isha këtu dhe faleminderit për ndihmën tuaj!

*Intervistoi:  
Dafina Ismajli,  
studente në Fakultetin e  
Gjuhës Angleze në AAB*





# Biblioteka e AAB-së vazhdimisht pasurohet me tituj më të rinj të librave shkencorë

*Biblioteka Universitare e AAB-së është e vetmja nga institucionet jopublike arsimore në vend që ka marrëveshje bashkëpunimi me Bibliotekën e Kongresit Amerikan për shkëmbim të materialit bibliotekar*

AAB-ja, bibliotekat e të tre kampuseve të veta: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë, i ka furnizuar me tituj të shumtë të rinj të librave shkencorë të ardhur nga shtetet e ndryshme të botës.

Drejtori i Bibliotekës së AAB, Urim Sallauka, ka bërë me dije se gjatë këtij viti të ri akademik kjo bibliotekë do të pasurohet edhe me më shumë tituj të librave të tjerë, të cilët do të jenë në dispozicion të studentëve dhe stafit të këtij institucioni, për qasje sa më të thellë në botën e shkencës, hulumtimit profesional etj.

Gjithashtu, Biblioteka e AAB-së është e vetmja nga institucionet jopublike arsimore në vend, që ka marrëveshje bashkëpunimi me Bibliotekën e Kongresit Amerikan për shkëmbim të materialit bibliotekar.

Biblioteka e AAB-së është e kompletuar edhe me staf profesional në tre kampuset universitare. Stafi i këtyre bibliotekave është i gatshëm t'u

shërbejë studentëve, hulumtuesve shkencorë dhe vizitorëve të tjerë.

Infrastruktura e Bibliotekës së AAB-së përbëhet nga shumë hapësira të veçanta: hapësira për vendosjen e librit, hapësira për lexim, hapësira për qasje në burimet elektronike etj. Krahas titujve të shumtë fizikë, Biblioteka Universitare AAB ofron mundësi qasjeje edhe në libraritë më të mëdha elektronike në botë si: JSTOR, Cambridge Journals, Oxford Reference, Oxford English Dictionary, OECD iLibrary, EBSCO etj., gjithashtu edhe në shumë portale të tjera akademike për të gjithë studentët dhe hulumtuesit shkencorë. Këta tituj të librave janë të renditur në raftet e kësaj biblioteke dhe mund të shfrytëzohen nga të gjithë të interesuarit.

Biblioteka e AAB-së është e hapur për studentë dhe stafin e vet çdo ditë prej orës 8:40 deri në orën 19:00.





# Projekt bashkëpunimi i AAB-së me Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë në fushën e bibliotekarisë

Në vazhden e bashkëpunimeve të vazhdueshme me institucione dhe zyre të njohura në nivelin botëror, për bartjen dhe shkëmbimin e përvojave në fushën universitare, së fundmi AAB-ja ka nisur një bashkëpunim edhe me Ambasadën e SHBA-së në Kosovë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Terry Plum, i dërguar i ambasadës në fjalë, ekspert i shkencave të bibliotekarisë dhe të informacionit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka vizituar për disa ditë me radhë AAB-në, respektivisht në bibliotekën e këtij institucioni. “Është punuar rreth shkathtësisë së infor-

macionit dhe planeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e bibliotekës dhe literaturës në përgjithësi”, ka thënë drejtori i kësaj biblioteke, Urim Sallauka.

Si pjesë e partneritetit afatgjatë, përfaqësuesi i Ambasadës së SHBA-së, z. Plum, ka takuar edhe menaxhmentin e lartë të AAB-së, me të cilët ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore. Në fund të vizitës, z. Plum u shpreh i kënaqur më të arriturat dhe punën që bëhet në këtë institucion të arsimit të lartë.



## AAB edhe sivjet më i kërkuari nga të rinjtë

*AAB si institucioni i parë në Kosovë (i themeluar nga sektori jopublik) edhe sivjet rezulton të jetë më atraktivi dhe më i kërkuari nga të gjitha institucionet private të Arsimit të lartë.*

Arsyeja pse AAB-ja është bërë atraktiv dhe joshës për të rinjtë kosovarë, është se, në këtë universitet janë bërë investime të mëdha e të gjithanshme. Me ndërtime të objekteve me infrastrukturë moderne, si në kampusin e madh në Prishtinë, por edhe në Ferizaj dhe Gjakovë, ku përfshihet edhe transporti gratis për të gjithë studentët e Universitetit, pastaj janë ndërtuar edhe objektet atraktive që përfshijnë salla moderne të mësimi, laboratorë, biblioteka, salla sportive dhe ambiente tjera studimore dhe relaksuese. Kur kësaj i shtohet edhe angazhimi i profesorëve më të njohur vendorë dhe ndërkombëtarë, e mbi të gjitha pranueshmëria e diplomave të AAB-së në tregun e punës, ku mbi 78% të të diplomuarve tanimë kanë zënë vende të punës në institucione, qoftë publike apo private, atëherë dihet arsyeja se çfarë e ka bërë këtë institucion kaq të kërkuar te të rinjtë.

Teknologjisë së avancuar në AAB, kohëve të fundit ju kanë shtuar edhe robotët e modelit më të ri NAO, të cilët rrallë se mund të gjenden

edhe në Universitetet më të njohura në botë.

AAB po ashtu njihet edhe si promovues i vlerave të Kosovës në vend dhe jashtë, qofshin ato shkencore, letrare artistike apo edhe sportive.

AAB-ja, po ashtu, e ka të organizuar edhe jetën sociale të studentëve, ku përfshihen aktivitete të ndryshme në klubet sportive që funksionojnë brenda saj. Vlen të theksohet se Klubi i Volejbollit të AAB-së për vite me radhë është kampion i Kosovës dhe fitues i shumëfishtë i kupës së Kosovës. AAB po ashtu i kushton një rëndësi të madhe aktiviteteve kulturore si organizimin e ekspozitave, promovimin e librave dhe i ka të themeluara pesë çmime ndërkombëtare të fushave të ndryshme që ju jepen personaliteteve të shquara të fushave përkatëse siç janë çmimet për të drejta e njeriut, për arritje shkencore, sportive, si dhe çmimin prestigjioz, më të madhin letrar në Ballkan, çmimin Ali Podrimja, që vitin e kaluar e fitoi shkrimtari shqiptar me famë botërore Ismail Kadare.

AAB-ja i ka të akredituara

dhe licencuara të gjitha programet, si dhe e ka akreditimin institucional, si dhe licencën pesë vjeçare, më të gjatën që e njehë ligji për arsimin e lartë në Kosovë.

Edhe kostoja financiare është e përballeshme për studentët, ngase çmimet e studimeve janë shumë të favorshme për rrethanat kosovare. Kushtet dhe afa-

tes e pagesave janë shumë të përshtatshme për studentë dhe, thjeshtë, studenti në AAB i ka të gjitha mundësitë për tu pajisur me dije dhe ekspertizë të nevojshme, çfarë edhe kërkohet në tregun e punës.

Gjatë katërmëdhjetë vjetëve të funksionimit, AAB-ja është bërë sinonim i dijes dhe suksesit të të gjithë

të rinjve të Kosovës. Prandaj, edhe në një anketë të zhvilluar këto ditë, ku janë të përfshirë një numër i madh i maturantëve, ka rezultuar që AAB-ja edhe sivjet bindshëmsh të institucioni për të cilën ka më së shumti interesim për të studiuar.

<http://www.gazetaexpress.com>





# U hap ekspozita tradicionale e studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Arteve të AAB-së

*"Studentët tanë, artistë të AAB-së, që janë të shumtë dhe kudo, me këtë ekspozitë dhe me aktivitetet e tjera po japin një kontribut të madh në jetën kulturore, artistike në nivel të vendit dhe më gjerë, po e bëjnë krenarë institucionin tonë si institucion të dijes, shkencës, artit e kulturës dhe AAB-në po e shndërrojnë në model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon", tha rektori i AAB-së, Lulëzim Tafa*



Në një ceremoni solemne dhe madhështore, në ambientet e Institucionit Arsimor AAB, në Prishtinë, u hap ekspozita kolektive tradicionale, e nënta me radhë, e studentëve të AAB-së. Në këtë ekspozitë, kurator i së cilës është prof. Fitim Aliu, e të cilën e shpallën të hapur rektori i AAB-së, prof. dr. Lulëzim Tafa dhe profesori Shyqyri Nimani, studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Arteve të këtij institucioni kanë ekspozuar punime të shumta nga të gjitha gjinitë e arteve pamore: arkitekturë, ilustrim, grafikë, grafikë reklamuese, multimedia, fotografi, pikurë, vizatim, art konceptual etj. "Ky është një moment jashtëzakonisht i bukur për AAB-në. Studentët shpërfa-

qin dijet dhe talentin e tyre në shkallë të lartë të profesionalizmit, duke ekspozuar kështu punimet e tyre nga kompetencat e ndërhuara në AAB, bashkë me profesorët e tyre. Është një thënie filozofike: 'Bota mund të konsiderohet si një vepër arti që e gjeneron vetveten'. Edhe studentët tanë, artistë të AAB-së, që janë të shumtë dhe kudo me këtë ekspozitë dhe me aktivitetet e tjera po japin një kontribut të madh në jetën kulturore, artistike në nivel të vendit dhe më gjerë. Po e bëjnë krenar institucionin tonë si institucion të dijes, shkencës, artit e kulturës dhe AAB-në po e shndërrojnë në model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon", tha rektori Tafa, në fjalën e tij të rastit.


**Ekspozita, të cilën sot po e shpalam këtu, në hapësirat e AAB-së, është bërë tashmë tradicionale dhe këtë vit ka një rëndësi të posaçme, meqë diplomojnë edhe studentët e parë të këtij fakulteti, i cili tashmë është i akredituar**

Ndërkaq profesor Shyqyri Nimani deklaroi se vlerat e kësaj ekspozite janë të jashtëzakonshme. "Ekspozita, të cilën sot po e shpalam këtu, në hapësirat e AAB-së, është bërë tashmë tradicionale dhe këtë vit ka një rëndë-

si të posaçme, meqë diplomojnë edhe studentët e parë të këtij fakulteti, i cili tashmë është i akredituar. Vlerat që mund t'i shikoni në këtë ekspozitë janë të një cilësie të jashtëzakonshme. E them këtë me plot kompetencë, meqë gjatë jetës sime në Universitetin e Prishtinës, por edhe si një vizitor i universiteteve të tjera evropiane e botërore, kam parë se cili është niveli i studentëve diplomantë. Unë mendoj se vërtetë një numër i madh i këtyre punimeve tashmë janë vepra të përsosura. Sipas plan-programit të aftësive arsimore, këta e kanë arritur maksimumin e maksimumeve, të mësimëve që është dashur t'i perceptojnë studentët sipas programeve të këtij universiteti prestigjioz, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon", ka vlerësuar Nimani.

Po ashtu, është promovuar edhe katalogu, në të cilin janë të përmbledhura punimet e studentëve nga kjo ekspozitë. Recensent i këtij katalogu, i cili është përgatitur në shqip dhe anglisht, është Shyqyri Nimani. Ekspozita është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, interpretuar nga studentët e Fakultetit të Muzikologjisë të AAB-së, "Kori AAB" dhe interpretime të tjera në piano, kitarë dhe videoamancione.





## Doli nga shtypi numri më i ri i revistës shkencore ndërkombëtare "THESIS"

Doli nga shtypi numri më i ri i revistës shkencore ndërkombëtare të AAB-së, "THESIS". Në këtë numër të revistës mund të lexoni studime shkencore dhe profesionale të rëndësishme nga fusha e gjuhësisë, komunikimeve, ekonomisë, psikologjisë, arkitekturës etj., të autorëve vendorë dhe të huaj. Numrin e ri të revistës mund ta merrni në objektin e

AAB-së, po ashtu së shpejti mund ta shfletoni edhe në uebfaqen zyrtare të këtij institucioni. "Thesis" është revistë kërkimore ndërkombëtare e botuar nga AAB-ja, e cila del dy herë në vit, edicioni i pranverës dhe vjeshtës. Revista ka ISSN the Bord ndërkombëtar. Ky është nr. i tetë i kësaj reviste shkencore ndërkombëtare.

## Logon e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan e dizajnoi studenti i AAB-së

Studenti i Institucionit Arsimor AAB në Fakultetin e Arteve, Programi Dizajn grafik, Berat Ymeri, është dizajnues i logos, të cilën tashmë e bart Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan. "Në këtë konkurs, përveç individëve të caktuar, janë paraqitur edhe kompani, të cilat janë me emër në Kosovë, por falë Zotit dhe njohurive të fituara gjatë ndjekjes së ligjëratave që kanë ndikuar në zhvillimin e ideve kreative dhe profesionale në këtë fushë, dola fitues i logos", ka thënë Berat Ymeri për "KNN".

Berati shton se është ndjerë krenar dhe i lumtur që doli fitues i kësaj gare. "Unë jam me preardhje nga Gjilani

dhe ndjej kënaqësinë kur shoh që studentët e këtij universiteti në indeksat e tyre dhe dokumente të tjera bartin logon që e kam dizajnuar unë", ka përfunduar ai.



UNIVERSITETI • UNIVERSITY  
"KADRI ZEKA"





# AAB-ja sjell Fakultetin Dizajni i Modës dhe lidh marrëveshje me disa universitete evropiane



Paralelisht programeve të tjera të studimit, Institucioni Arsimor AAB në vitin akademik 2014/15 ka sjellë edhe programin e ri të akredituar për studime në Dizajn të Modës. Sipas përgjegjësit të këtij fakulteti, përveç infrastrukturës tejet moderne: salla të mbushura me aparatura të punës, që i duhen një studenti për punë praktike, në këtë fakultet janë të përfshirë një numër i madh i stafit akademik, që janë të pajisur me dije, studime dhe diploma nga universitetet më prestigjioze në Evropë dhe më tej, si Krenare

Rugova, Vjollca Lllapashtica, Albulena Borovci, Damiana Celcar, Tanja Devetak, Guliana Peveta, Afërdita Statovci, Aida Saraqini etj.

Ky fakultet ka lidhur marrëveshje me disa universitete evropiane që njihen në botën e dizajnit siç janë: Nuova Accademia di Belle Arti Milano (NABA) në Italy, Academy of Design Ljubljana në Slloveni, si dhe Universitetin Mimar Sinan në Turqi. "Marrëveshja me këto universitete parashih zhvillimin e planprogrameve, mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve,

organizimin e eventeve artistike, shkencore me nivel ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrjet e përbashkëta në projekte", deklaroi përgjegjësi i programit të Dizajnit të Modës.

Ky program dallohet për kërkimet/hulumtimet në veshje, pastaj për potencialet që mund të shtrihen në fusha të tjera të botës të modës (aksesorë, tekstilë, enterierë, metodat e komunikimit të modës, ekspozimi imulti-medies) dhe për disiplinat përkatëse të dizajnit (të projektimit dhe arkitekturës).

Ky program i nivelit universitar aftëson dhe përgatit kuadro për tregun kosovar dhe në nivelin botëror. Njohuritë profesionale, të cilat studenti mund t'i marrë në këtë fakultet, mund t'i shfrytëzojë në të ardhmen për ta drejtuar ndonjë sallon modeli, shtëpi mode, të punojë në ndonjë fabrikë tekstili si konsulent mode, apo edhe në ndonjë medium etj.







# English Language Academy

Shkolla e Gjuhëve të Huaja

REGJISTROHU TANI

www.ela-ks.com

**Anglishte e përgjithshme**

- I rregullt
- Intensiv
- Individual

**Kurse përgatitore për provime**

- IELTS
- TOEFL

**Anglisht për qëllime specifike**

- Anglishte biznesi
- Anglishte akademike
- Anglishte ligjore

**Orët mësimore**

|                       |        |
|-----------------------|--------|
| Starter – A1          | 42 orë |
| Elementary-A2         | 62 orë |
| Pre-intermediate B1   | 62 orë |
| Intermediate B1+      | 62 orë |
| Upper-intermediate B2 | 62 orë |
| Advanced C1           | 62 orë |
| Proficiency C2        | 62 orë |



Kontakti:

**Prishtinë:**  
Lumnije Zuka,  
lumnije.zuka@ela-ks.com  
Biblioteka Universitare  
Tel.: 044 341 214, 049 288 031

**Ferizaj:**  
Lindita Jusufi,  
lindita.jusufi@ela-ks.com  
Zyra e koordinatorit të cilësisë  
Tel.: 044 77 90 90

**Gjakovë:**  
Valjeta Dobrosi,  
valjeta.dobrosi@ela-ks.com  
Shërbimi i studentëve  
Tel.: 044 21 00 21

Në bazë të nenit 33, pika 11 të Statutit të Universitetit AAB dhe në bazë të Rregullores për Studimet MASTER, Universiteti AAB shpall:

**KONKURS**

Për regjistrimin e studentëve të rinj në studimet MASTER për vitin akademik 2014/2015



APLIKO  
TANI

**Kushtet për aplikim**

- Diploma e nivelit Bachelor ose ekuivalente me të;
- Certifikata e lindjes
- Kopja e Dokumentit të Identifikimit

**Kontakt adresa:**

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,  
Tel: 038/ 555 444; 038/ 601 019, Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666

Dega në Gjakovë: 044 21 00 21, 049 582 588;  
Dega në Ferizaj: 0290 328 908, 044 77 90 90



Institucioni i Arsimit  
**UNIVERSITAR AAB**

Programet MASTER të akredituara:

**ADMINISTRATË PUBLIKE**

- Administratë Publike dhe Diplomaci

**EKONOMI**

- Banka dhe Financa
- Menaxhment dhe Informatikë
- Marketing dhe Menaxhim Biznesi

**GJUHË TË HUAJA**

- Gjuhë Angleze

**JURIDIK**

- Civil-Juridik
- Penal-Juridik

**KOMUNIKIM MASIV**

- Komunikim Masiv dhe Gazetari

**KULTURË FIZIKE**

- Kulturë Fizike dhe Sport

**MENAXHIM SEKTORIAL**

- Menaxhim i Sektorit të Arsimit
- Menaxhim i Sektorit të Kulturës
- Menaxhim i Sektorit të Shëndetësisë
- Menaxhim i Sektorit të Sportit

**SHKENCA KOMPJUTERIKE**

- Shkenca Kompjuterike

**SHKENCA SOCIALE**

- Politikat sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve

Aplikimi mund të bëhet në objektet e Universitetit AAB, Objekti I, Qendra e Regjistrimeve – kati i parë apo online nga webfaqja zyrtare [www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)



## LG prezanton modelin AKA, telefonin me “sy”

LG ka prezantuar një model të ri të telefonit të mençur në Android, të quajtur LG AKA, që është i dizajnuar për njerëzit në vendin e saj të origjinës, përkatësisht në Korenë e Jugut, të cilët duan pak më shumë personalitet në pajisjen e tyre mobile. AKA do të vijë në katër “karakterë” të ndryshme virtuale nga të cilat përdoruesit mund të zgjedhin.



Telefoni i ri i LG vjen me ekranin prej 5 inç dhe mbështjellësin që mbulon tre të katërtat e anës së përparme të pajisjes. Pjesa tjetër e mbetur e telefonit është e rezervuar për të treguar sytë virtual të telefonit që përfaqësojnë katër karaktere.

Të gjitha këto karaktere kanë personalitetin e tyre dhe tregimet prapa tyre, dhe me këtë LG shpreson se AKA do tu ndihmojë përdoruesve të telefonit të lidhen më shumë me pronarët e tyre. Karakteristikat harduerike të LG AKA janë të një telefoni mesatar, megjithatë i njëjti

ofron Android Kitkat me një procesor prej 1.2 GHz, 1.5GB RAM, 16GB hapësirë të magazinimit të brendshëm, dhe kamerën e pasme me 8MP, si dhe atë të përparmen me 21.MP. LG AKA është planifikuar të dalë në Korenë e Jugut me një çmim prej 460 dollarëve.

## Krijohet loja “Autochthonous”

Është bërë një lojë për platformën Playstore me emrin “Authothonous” nga OnAir Media.



“Kemi nderin të ju njoftojmë se në Playstore për Android, nga OnAir është publikuar Loja e parë me Dronin Shqiptarë që shkroi historinë në Beograd”, thuhet në faqen zyrtare të kësaj kompanie.

Express ka mësuar se kjo lojë është mundësuar nga programeri i OnAir, Yusuf Aliya.

Më poshtë keni linkun ku mund të shkarkoni lojën:

[play.google.com/store/apps/details](http://play.google.com/store/apps/details)

## Qeveritë rrisin kërkesat për censurim në Facebook

Tani më shumë se kurrë, qeveritë në mbarë botën janë të etura për të marrë në duart e tyre të dhënat në lidhje me përdoruesit e Facebook - dhe tani më shumë se kurrë, ata duan ta heqin përmbajtjen e padëshiruar, dhe ta zhdukin atë nga rrjeti më i madh social në botë.



Kërkesa globale e mbikqyrjes për të dhënat e përdoruesve të Facebook në gjysmën e parë të vitit 2014 është rritur për 24%, në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2013, thuhet sipas raportit të transparencës së rrjetit social Facebook. Një total prej 34.946 kërkesave janë bërë në mes të janarit dhe qershorit, duke përfshirë mesazhet, IP adresat dhe informacione rreth llogarisë së përdoruesve. Censura po ashtu është në rritje në mbarë botën; krahasuar me qershor deri në dhjetor 2013, sasia e përmbajtjes së censuruar në Facebook është rritur me 19%, sipas raportit. Në raportin e transparencës, është përfshirë edhe Shqipëria duke detajuar kërkesat e qeverisë për të dhëna të përdoruesve. Përgjatë periudhës janar – qershor të këtij vitit, kërkesa për të dhëna e përdoruesve janë 4, ndërsa llogari të prekura janë 6, kur në total këto përbëjnë një rritje me 75 % krahasuar me një vit më parë.

Ndërsa Qeveria e Kosovës përgjatë gjysmës së parë të këtij viti ka bërë 9 kërkesa për të dhëna përdoruesish, ku janë prekur plot 25 llogari. Kjo përbën një rritje me 44 % krahasuar me një vit më parë. Maqedonia pothuaj qëndron në një linjë me Kosovën ku në total janë bërë 10 kërkesa dhe prekur 12 llogari të përdoruesve, një rritje me 40 % krahasuar me një vit më parë. Për Serbinë nuk shfaqen të dhëna, ndërsa qeveria e Malit të Zi ka bërë në total 2 kërkesa dhe janë prekur 2 llogari, raporton, PCWorld Albanian. Facebook nuk është shërbimi i vetëm që ka parë një rritje të tillë të mprehtë në kërkesat e mbikqyrjes dhe censurës së përmbajtjes së saj. Në shtator, Google zbuloi se kërkesat për të dhënat e përdoruesve të saj nga qeveritë e vendeve të ndryshme të botës janë rritur për 15% në krahasim me gjashtë muaj më parë, që do të thotë një rritje prej 150% gjatë pesë viteve.



## 2015, Lenovo me laptopin më të lirë Chromebook



*Linja e laptopëve Chromebook tradicionalisht ka qenë e lirë dhe e përballueshme në krahasim me rivalët që bazohen në Windows 8, pasi që shumica prej tyre nuk a kalojnë shumë prej 317 dollarëve, edhe pse në treg ka modele edhe më të lira se kaq.*

Sipas një raporti të ri, njëri prej prodhuesve të laptopëve është duke u munduar që të ofrojë një model edhe më të lirë të laptopit Chromebook, i cili thuhet se do të kushtojë më pak se 170 dollarë.

Dhe ky prodhues është gjiganti Lenovo, i cili modellet e reja të laptopëve të saj do ti bazojë në CPU nga kompania kineze Rockchip Electronics, ndërsa me prodhimin e tyre do të merret Bitland Information Tech-

nology.

Dhe siç thuhet, kompania Lenovo është duke e bërë gati linjën e laptopëve Chromebook për lansim në vitin 2015, dhe mbase do ti bëjë edhe prodhuesit tjerë që të krijojnë modele konkurruese edhe sa i përket çmimit. Acer C720 aktualisht është modeli më i lirë i laptopit Chromebook, i cili shitet për rreth 267 dollarë.

## Kosova, nr.1 në Ballkan për internet

*Kosovarët janë përdoruesit më të fuqishëm të internetit në Ballkan, mësohet nga një vërtetim botëror për penetrimin e internetit dhe Facebook-ut.*

Vërtetimi i Internet World Stat, mbi përdorimin e internetit thotë se 76.6 për qind e 1.8 milionë banorëve të Kosovës përdorin internetin në vitin 2013. Por Kosova është gjithashtu nga të pakat vende për të cilat mungojnë të dhënat mbi përdorimin e Facebook.

I dyti në Ballkan për përdorimin e internetit qe Kroacia, ku 70.9 për qind e popullatës shkoj online. Kjo do të thotë se 3.1 nga 4.4 milionë banorë qenë përdorues të rregullt. Gjithsesi, kroatët nuk duken shumë të interesuar për Facebook, për shkak se "vetëm" 1.6 milionë prej tyre e përdorin këtë rrjet të medias sociale.

Njerëzit në Bosnjë dhe Hercegovinë u renditën të tretët me 67.9 për qind penetrimit të përdorimit të internetit. Kjo do të thotë se 2.6 milionë nga një popullatë prej 3.8 milionë njerëzish e përdorin. Numri i përdoruesve të Facebook qe 1.3 milionë gjë që përbën gjysmën e përdoruesve të internetit.

Maqedonia, ku 62.2 për qind e popullsisë përdor internetin, qe e katërta në listë. Rreth 1.3 milionë njerëz nga 2.1 milionë banorë qenë përdorues. Një pjesë e madhe e tyre, 962 mijë, përdornin gjithashtu Facebook.



Shqipëria është nga vendet e mesit në listë me 60.1 për qind penetrimit interneti sipas të dhënave të këtij studimi. Kjo do të thotë se rreth 1.8 milionë nga 3 milionë banorë qe përdorues dhe shumica e përdoruesve, rreth 1.1 milionë kanë llogari në Facebook.

Niveli i përdorimit të internetit në Serbi qe 57 për qind ose 4.1 milionë banorë. Përdorimi i Facebook këtu është gjithashtu i lartë me 3.3 milionë llogari.

Në Malin e Zi norma e penetrimit të internetit është 56.8 për qind ose 365 mijë banorë nga një popullatë

prej 650 mijë vetësh. Rreth 300 mijë prej tyre përdorin edhe Facebook.

Bullgaria, me popullatë prej 6.9 milionë banorë pati normë penetrimit në internet prej 53.2 për qind ose 3.6 milionë përdorues. Rreth 2.5 milionë prej tyre kishin edhe profile në Facebook.

E fundit në listë qe Rumania me normë penetrimit interneti 49.8 për qind. Rreth 10.8 milionë nga 22 milionë banorët e Rumanisë përdorin rrjetin dhe nga këto, 5.3 milionë kanë llogari në Facebook.

## YouTube e konfirmon shërbimin e muzikës me abonim

*Ka pasur mjaft thashetheme rreth shërbimit të ri të abonimeve të muzikës në YouTube, për të cilin thuhet se do të fillonte gjatë verës së këtij viti, gjë që nuk ka ndodhur deri më tani. madje, këtë lajm e kishin dhënë disa nga zyrtarët e Google që është pronare e shërbimit të famshëm të videove në internet, YouTube.*

Mirëpo, kësaj radhe ka qenë drejtoresha ekzekutive e YouTube, Susan Wojcicki ajo që e ka dhënë konfirmimin për lansimin e shërbimit me abonim për muzikën në YouTube.

Në një intervistë të dhënë në Code/Mobile, drejtoresha e YouTube ka thënë se ajo dhe ekipi i saj janë duke punuar "në atë drejtim", dhe se tanimë janë afër realizimit

të qëllimeve të tyre.

Por, ajo nuk e ka konfirmuar nëse shërbimi i ri i YouTube do të quhet ose jo, Music Key, ndërsa ajo më shumë është koncentruar në atë se çfarë opsione do tu ofrohen përdoruesve të këtij shërbimi të ri, dhe çmimet që do ti ketë shërbimi për secilin abonues individual.

Dhe duke pasur parasysh se shërbimi do të përfshi-

jë pamjet e koncerteve dhe video të tjera, vendosja e çmimit mund të jetë pak më e ndërlikuar se sa ofertat e shërbimeve që konkurrentët si Spotify i kanë.

Nuk është e qartë se kur saktësisht do të shohim këtë shërbim gati për publikun, por kjo është të paktën një tregues që shërbimi do të lëshohet brenda një kohe të shkurtër.





# AAB nderoi studenten Majlinda Kelmendi me Çmimin Ndërkombëtar për Arritje në Sport



Në një ceremoni solemne, Institucioni Arsimor AAB ia dha Çmimin Ndërkombëtar për Arritje të Lartë në Sport, kampiones së Evropës dhe Botës në Xhudo, Majlinda Kelmendit. Ky çmim u jepet sportistëve të shquar

për arritje të lartë në sport dhe që kanë fituar në gara ndërkombëtare. Me këtë rast, rektori i AAB-së, Lulzim Tafa, duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve në këtë ceremoni solemne të dhënies së këtij çmimi, tha

se Institucioni Arsimor AAB, pos çmimit për të Arriturat në Sport, të cilin ia ndanë kampiones së Botës në Xhudo, Majlinda Kelmendit, AAB-ja ka të themeluar edhe katër Çmime Ndërkombëtare të fushave

të ndryshme si: Çmimin për të Arritura Shkencore, Çmimin për të Drejtat e Njeriut, Çmimin për Arte dhe Letërsi dhe Çmimin për Demokraci e Integrim. "Rregullorja e AAB-së për këto çmime i ka të përcaktuara kriteret e qarta në ndarjen e çmimit. Kësaj radhe komisioni vlerësues nuk e ka pasur të vështirë vendimin, ngaqë fituesin e sivjetmë të çmimit të AAB-së për Arritje të Lartë në fushën e sporteve nuk kemi pasur nevojë ta kërkojmë as në botë, as në Evropë, as në rajon, sepse e kemi gjetur këtu në Kosovë. Madje për ne si universitetet ka ndodhur mrekullia sepse e kemi gjetur në mesin tonë, studenten e zellshme të Fakultetit të Sporteve, kampionen e botës në xhudo, Majlinda Kelmendi", tha rektori Tafa.

Ai tha se në këta 14 vjet të funksionimit të AAB-së kanë dalë shumë studentë të vyer e profesionistë të fushave të ndryshme, të cilët me kompetencë e profesionalizëm po veprojnë suksesshëm në tregun e punës. "Të diplomuarit tanë i gjënë të punësuar kudo, në sektorin publik dhe atë privat, i gjen juristë të zotë, ekonomistë, gazetarë, arkitektë e sportistë të respektuar. Ne krenohemi me ata, ashtu si edhe ata me ne, me kompetencat dhe dijen e ndërtuar këtu. Ne e kemi edhe klubin e volejbollit të femrave, i cili pothuajse është i pakonkurrencë në Kosovë. Shumë vite me radhë vajzat e AAB-së na stolisnin me kupën e kampionit të Kosovës në Volejball. Kemi edhe kampione në fusha e disiplina të ndryshme, por sukcesi më i madh i AAB-së dhe i Kosovës, është Majlinda që shquhet edhe si studente dhe si sportiste", u shpreh rektori Tafa. Ai tha se shembull për studentët dhe për rininë e Kosovës i shtëpisë së AAB-së është edhe Driton Kukaj, farkëtuesi i gjiganteve botërore në Kosovë, i cili po jep një kontribut të jashtëzakonshëm në Fakultetin e Sporteve në AAB. "Mos të harrojmë se të gjitha sukseset e Majlindës lidhen edhe me Dritonin. Me përkushtimin e Dritonit lidhen edhe sukseset e kam-

pioneve të tjerë si Distris, Norës e shumë xhudistëve të tjerë. Me këta njerëz AAB-ja është shtëpia e kampioneve dhe kampione e arsimit, dijes e shkencës. Ne në AAB e dimë se si kemi arritur deri këtu ku jemi, me punë të madhe, me shërbime të shpejta dhe efikase administrative, me mësimdhënësit, objektet, literaturat dhe studentët më të mirë në rajon. Ne kemi vizion të çartë se ku duam të shkojmë, duke siguruar arsimim cilësor për të gjithë dhe duke kontribuar në mënyrë vendimtare në zhvillimin dhe integrimin e Kosovës me dijen dhe shkencën në tregun evropian".

Ai tha se Majlindës dhe Dritonit u dëshiron suksese të reja edhe në të ardhmen, sidomos në garat e ardhshme olimpike. Ndërkaq kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, në fjalën e tij tha se Majlinda Kelmendi është një aset që e ka Kosova dhe të gjithë shqiptarët kudo që janë. "Aseti është një vlerë, një pasuri e cila normalisht duhet të shfrytëzohet. Se sa do ta shfrytëzojë shteti mbetet për të parë. Në Komitetin Olimpik, por edhe në shumë federata të tjera e shfrytëzojnë si një vlerë për të arritur një qëllim sublim që e kemi, ndërkombëtarizimin e sportit tonë, që të jemi të barabartë me të tjerët dhe në mënyrë të barabartë të marrim pjesë jo vetëm në kampionate evropiane e botërore, por edhe në Lojërat Olimpike", tha Hasani. Ai uroi Majlinda Kelmendin për këtë çmim, duke shtuar se sportistët e Kosovës do të marrin pjesë në lojërat olimpike që do të mbahen në Rio De Zhaniero.

Driton Kukaj, trajner i kampiones së botës, Majlinda Kelmendi, tha se krahas mbështetjes institucionale dhe fitores së titullit të botës në xhudo, për atë ka ndodhur edhe një ngjarje shumë e veçantë pas takimit me drejtuesit e AAB-së. "Takimi me udhëheqësit e AAB-së ka qenë shumë emocional. Gjithmonë kam pasur dëshirë të përfundoj një ditë si profesor, në mënyrë që dijen e tyre profesionale



ta përcjellin tek të rinjtë e Kosovës, sidomos në Kulturën Fizike. Jemi takuar me stafin udhëheqës të AAB-së dhe vizioni i tyre ka bërë që ne sot të jemi pjesë e këtij institucioni dhe me krenari po them se kanë zgjedhur një rrugë shumë të shkëlqyeshme. Majlinda dhe Nora janë demonstratore të sportit të xhudus pranë institucionit AAB. Këto kanë ato të cilat kanë kontribuar që sportistët kulminantë ta kenë vendin aty ku duhet”, u shpreh trajneri i kampiones së botës, Driton Kukaj. Ndërkaq lauratja e Çmimit Ndërkombëtar për Arritje të Lartë në Sport, Majlinda Kelmendi, falënderoi AAB-në për këtë çmim, duke thënë se ndihet e privilegjuar pasi më parë çmim të këtij rangi ka marrë edhe shkrimtari i mirënjohur shqiptar, Ismail Kadare, në këtë universitet. “Është nder për mua të jem pjesë e AAB-së, institucionit arsimor dhe shkencor më të mirë në rajon. Ju falënderoj shumë që më keni dhënë mundësi që dijen time që e kam në aspektin sportiv, ta tregoj në këtë institucion ar-

simor, i cili është më i mirë në rajon”, u shpreh kampionia e botës në xhudo, Majlinda Kelmendi. Ndërkaq, në fund të kësaj ceremonie, rektori i AAB-së, Lulzim Tafa, ia dhuroi asaj Çmimin Ndërkombëtar për Arritje të Lartë në Sport, kurse kampionia e botës ia dhuroi rektorit Tafa Medaljen e Artë të Kampionatit Botëror. Rektori Tafa, me rastin e pranimit të dhuratës nga kampionia, tha se është një emocion i papërshkruar sepse janë të rralla ato universitete në botë dhe të rrallë ata rektorë që kanë fatin dhe mundësinë që prej studentëve të tyre ta marrin medaljen e artë të fituar në një kampionat botëror. Në këtë ceremoni solemne, në të cilën i pranishëm ishte prezantuesi i mirënjohur shqiptar, njëherësh edhe profesor në AAB, Adi Krashta, u transmetuar edhe një dokumentar dedikuar karrierës së kampiones së botës, Majlinda Kelmendi.



## Fisnik Memeti, student i AAB-së, dhe basketbollist i njohur në arenën ndërkombëtare

Fisnik Memeti, student në Fakultetin e Ekonomisë në AAB, është basketbollist i njohur kosovar, pasi ka bërë emër edhe në arenën ndërkombëtare. Me paraqitjet e tij solide, ai është shpërblyer me shumë medalje dhe mirënjohje. Fisniku ka luajtur për Klubin “Union Olipija” nga Lubjana e Sllovenisë dhe Klubin “Sharpen të Lyonit” të Francës etj., ndërsa nga viti i ardhshëm do të transferohet tek gjiganti gjerman, Bayern. “Kam marr pjesë me Përfaqësuesen e Kosovës me juniorë në Gracë të Francës dhe kemi qenë kampion i turneut. Pastaj kam qenë përfaqësues i Kosovës për seniorë, duke marr pjesë nëpër turne në Jordani,

Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi etj”, tregon “Fisi”. Si sportist me famë, ka marrë shumë medalje dhe mirënjohje. Është shpallur Sportisti i Vitit në 2006 dhe ka marrë Kupën. Ai për revistën e AAB-së thotë se “shumëçka kisha ndryshuar, por më kryesoret për një sportist kosovar janë kushtet elementare, të cilat mungojnë si, p.sh., motivimi i tyre, mosangazhimi i të rinjve nëpër klube të mëdha, përkrahja, kushtet financiare, kushtet e dobëta të klubeve në stërvitje”, vazhdoi Mehmeti. Po ashtu, Fisniku tregon se në Kosovë ka luajtur për disa klube si “Drita”, “Mabetex”, “Dukagjini”, “Bashkimi” etj.







# Sharri<sup>®</sup>

UJË NATYRAL / NATURAL WATER

**Nga Zemra e Brezovicës**

*T'i kthjellë sytë*



**Uji më i mirë në vend.**





# Model Slovenia

C O N S T R U C T I O N



**Bleje banesën me këste  
për 3 vite pa kamatë**



Prishtinë – Kosovë, Tel: +386 (0)49 672 000, +377 (0)45 295 006,+386 (0)49 132 056  
web: [www.modelslovenia.com](http://www.modelslovenia.com) , mail: [info@modelslovenia.com](mailto:info@modelslovenia.com)



**cilësi, lidership, sukses!**



# Institucioni i Arsimit UNIVERSITAR AAB

## EKONOMIK

- BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET
- MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI
- MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

## SHKENCA KOMPJUTERIKE

- INXHINIERI SOFTUERIKE
- KOMUNIKIMI NË RRJETA
- TELEKOMUNIKIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT (IT)
- MEKATRONIKË

## JURIDIK

## KRIMINALISTIKË

## INTEGRIME EVROPIANE

## KUJDESI DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE

## PSIKOLOGJI

## GJUHË ANGLEZE

## KOMUNIKIM MASIV DHE GAZETARI

- GAZETARI
- PRODUKSION

## ADMINISTRATË PUBLIKE

## SHKENCA POLITIKE DHE DIPLOMACI

## KULTURË FIZIKE DHE SPORT

## ARKITEKTURË

## DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA

## DIZAJN ENTERIERI

## DIZAJN I MODËS

## PIKTURË DHE ARTE VIZUELE

## MUZIKË

AAB ju ofron mundësinë që të studioni në gjuhën angleze në Programet Ndërkombëtare të Universitetit të Londrës

**London School of Economics and Political Science:**  
me programet **Bachelor** dhe  
**Royal Holloway** me programet **Master**

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,  
Tel: 038/ 555 444; 038/ 601 019  
Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666

Dega në Gjakovë: 0390/ 327 444, 045/ 552 333  
Dega në Ferizaj: 0290/ 328 908, 044/ 77 90 90

[info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net)

[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

[f /UniversitetiAAB](https://www.facebook.com/UniversitetiAAB)